

09

OJQ YMCA MOVEMENT-YMCA LEVIZJE GJAKOVË

Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare më dhe përvitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2020

Gjakovë, Prill 2021



PERMBAJTJA

FAQE

RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR.....	3
PASQYRA E PASURIVE, GJENDJES SE FONDEVE DHE DETYRMEVE.....	5
PASQYRA E BURIMEVE DHE SHFRYTËZIMIT TE FONDEVE.....	6
SHËNIMET NË PASQYRAT FINANCIARE.....	7 -19

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për menaxhmentin e Organizatës YMCA MOVEMENT-YMCA LEVIZJE

Opioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te organizates YMCA MOVEMENT-YMCA LEVIZJE nga Gjakova/R.Kosovës (Organizata), te cilat përfshijnë Pasqyrën e Pozicionit Financiar me datë 31 dhjetor 2020 ,Pasqyrën Gjithëpërfshirëse të të ardhurave , Pasqyrën e Fluksit të Mjeteve Monetare, dhe shënimet e pasqyrave financiare, duke përfshirë edhe një përbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat e bashkangjitura financiare të Organizatës janë përgaditur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me bazën e kontabilitetit siç përshkruhet në shënimin 2.1 në këtë raport.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në perputhje me Standarde Ndërkombëtare te Auditimit (SNA) Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në përgjegjësin e auditorit për auditimin e seksionit për pasqyrat financiare të reportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Organizata dhe në perputhje me Kodin e etikës të kontabilistëve profesional të leshuar nga Bordi i Standardeve Nderkombëtare të Etikës për Kontabilistë (Kodi i BSNEK) dhe se kërkesat etike qe janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përbushur përgjegjësitë tona të tjera etike ne përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit qe ne e kemi marrë është e mjaftuesme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Çështje për t'u theksuar - Baza e Kontabilitetit dhe Kufizimi i Shpëndarjes

Ne tërheqim vëmendjen në shënimin 2.1- të pasqyrave financiare, e cila përshkruan bazën e kontabilitetit. Pasqyrat financiare janë pregaditur për të siguruar informacione për donatorët e YMCA MOVEMENT-YMCA LEVIZJE IN KOSOVO dhe për qëllime te raportimit për të interesuar të tjerë. Si rezultat i kësaj, pasqyrat financiare mund të mos janë të përshtashme për një qëllim tjetër. Opinion ynë nuk është i modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Çështjet tjera

Pasqyrat Financiare te Organizates janë audituar edhe vitin e kaluar dhe është dhënë opinion i pa kualifikuar për to.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF, dhe për kontrolllet e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së OJQ-së për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përvèç nëse menaxhmenti synon të likuidojë OJQ-në apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativ tjetër të mundshme përvèç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit finansiar të OJQ-së.


Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretim, apo shkelje të kontolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrolllet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimin të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontolleve të brendshëm të OJQ-së.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërin e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojm mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit te vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruara të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e OJQ-së për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në reportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tillë janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojë që OJQ-ja të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrolllet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.


Nimon Zeneli, Auditor Ligjor
Rruga "Skenderbeu" nr 17 TOR No 45
50000 Gjakovë
Republika e Kosovës
Tel:044/421 719
e-mail:nimonzeneli@hotmail.com

Gjakovë, 14 Prill 2021

"YMCA "
Pasqyra e pozitës financiare
më 31 dhjetor 2020

	Shënim	2020 €	2019 €
PASURITË			
Pasuritë qarkulluese			
Mjetet e gatshme në arkë	3	392	1,028
Mjetet e gatshme në bankë	3	114,693	34,840
Stoqet	4	2,568	6,267
Kerkesat tjera		-	-
Gjithsejt mjetet qarkulluese		117,653	42,135
Pasuritë afatgjata			
Toka	5	40,820	40,820
Objekti		33,414	34,293
Automjetet	5	19,479	16,883
Inventari dhe paisjet	5	17,241	15,258
Investimet ne vijim-CAMPI	5	89,333	89,333
Gjithsejt pasuritë afatgjata		200,287	196,587
Gjithsejt pasuria		317,941	238,722
DETYSIMET DHE EKUITETI			
DETYSIMET			
Detyrimet afatshkurtëra			
Llogaritë e pagueshme	6	-	3,454
Kontributet pensionale	6	711	672
Tatimi ne paga	6	379	306
Tatimi në qira i pagueshëm		69	112
Gjithsejt detyrimet afatshkurtëra		1,159	4,544
Detyrimet afatgjata			
Rezervat (te hyrat e shtyera)	7	97,383	46,493
Gjithsejt detyrimet afatgjata		97,383	46,493
EKUITETI			
Fondi		219,399	187,685
Fitimet e mbajtura		-	-
Rezervat e tjera		-	-
Gjithsej ekuiteti		219,399	187,685
Gjithsejt detyrimet dhe ekuiteti		317,941	238,722
		0	-
Drejtoresha egzekutive			Zyrtari finanziar
Dorina Davies			Erina Arllati



Të aprovuara dhe lëshuara nga menaxhmenti dhe të nënshkruara në emër të tij më 29 Mars 2021.

Shënimet shoqëruese prej 1 deri 15 janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave finançiar

8

"YMCA MOVEMENT-YMCA LEVIZJE IN KOSOVO"
Pasqyra gjithpërfshirëse e të ardhurave
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020

	Shënim	2020 €	2019 €
I.Të Hyrat			
Të hyrat nga donatorët e jashtëm	9	151,027	44,492
Te hyrat nga donarët në vend	9	6,836	44,675
Te hyrat nga dyqani	9	16,060	11,653
Te hyrat per zhvlersim te pasurive nga donacionet	9	<u>15,313</u>	<u>10,217</u>
Gjithsejt të hyrat		<u>189,236</u>	<u>111,037</u>
Shpenzimet operative			
Shpenzimet e projekteve	10	80,924	22,456
Shpenzimet e personelit			
Pagat bruto	11	61,758	49,080
Kontributet për sigurim pensional	11	<u>2,973</u>	<u>2,432</u>
Gjithsejt shpenzimet e personelit		<u>64,731</u>	<u>51,512</u>
Shpenzimet tjera operative			
Qiraja		9,109	7,365
Rryma,interneti,materialet,tel	11	8,696	1,798
Anëtarsia	11	665	665
Shpenzime te udhimit brenda dhe jasht vendit	11	3,210	4,541
Ushqim dhe pije	11	901	373
Mirembajtje dhe riparim	11	448	2,057
Shpenzimit e auditimit	11	1,000	1,000
Sherbime te kontabilitetit	11	1,500	-
Provizioni bankar	11	889	548
Shpenzimet e zhvlersimit	11	15,313	10,217
Renovimi I shtepis se pleqve ne Gjakove	11	-	3,010
Shpenzimet e renovimit te Objektit-dyqanit	11	-	3,001
Shpenzime tjera	11	<u>1,851</u>	<u>2,494</u>
Gjithsejt shpenz tjera operative		<u>43,581</u>	<u>37,069</u>
II.Gjithsejt shpenzimet		<u>189,236</u>	<u>111,037</u>
III.Fitimi/humbja e periudhës		<u>0</u>	<u>0</u>

"YMCA MOVEMENT-YMCA LEVIZJE IN KOSOVO"
Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020

	Shënim	2020	2019
		€	€
A.Aktivitetet Operative			
Të hyrat nga aktiviteti operativ	9	16,060	11,653
Dalja e parasë për shpenzimet operative	10	-173,923	-104,768
Neto paraja e gatshme nga aktiv. operativ		-157,863	-93,115
B.Paratë e Gatshme nga aktiv. Investuese			
Paraja e gatshme nga shitja e mjeteve fikse		0	0
Dalja e parasë së gatshme për blerjen e aseteve	5	-26,400	-53,202
Neto paraja e gatshme nga aktiv. investues		-26,400	-53,202
C.Paratë e Gatshme nga aktivit. financues			
Paraja e gatshme nga financimi i donatorëve	9	262,705	164,882
Paraja e gatshme nga anëtarësia	9	775	0
Dalja e parasë së gatshme nga aktiviteti financues			
Neto paraja e gatshme nga aktiv. financues		263,480	164,882
Neto par e gatsh nga aktiv.oper, inv dhe fin		79,217	18,565
Par e gatshme dhe ekuival, në fillim të vitit		35,868	17,303
Par e gatshme dhe ekuival, në fund të vitit	3	115,085	35,868

YMCA MOVEMENT-YMCA LEVIZJE IN KOSOVO

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në euro)

1. HYRJE

a). Korniza ligjore

YMCA MOVEMENT-YMCA LEVIZJE (në testin e mëtejmë OJQ "YMCA MOVEMENT") është themeluar konformë rregullave të Ligji T nr 06/L-043 Për Lirin e Asociimit në Organizata Joqeveritare ku është identifikuar me numër 5114389-2 me datë 28 Shkurt 2013, ndërsa nga Administrata Tatimore e Kosovës është paisë me Numër Fiskal 600950043 me datë 11 Mars 2016.

OJQ "YMCA MOVEMENT" është organizatë joqeveritare dhe jo profitabile. Në përputhje me rregullat e nenit 4 të Ligjit nr 06/L-043 Për Lirin e Asociimit në Organizata Joqeveritare, nuk shpërndan të ardhura neto ose fitime për asnjë person. Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e saj përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse. Poashtu nuk përdoren për të sjellë drejpërdrejtë ose tërthorazi përfitime, për ndonjë themelues, drejtor, nëpunës, anëtar, punonjës ose donatorë të OJQ-së. Mirëpo nuk pengon pagesën a kompensimin e arësyeshëm për personat që e kryejnë punën për shoqatën.

YMCA MOVEMENT në vijimësi ka pasur perkrahje nga World YMCA me seli ne Gjeneve ne Zvicer, Y USA me seli ne Çikago ne SHBA, Y's Men International ne Danimarke, YMCA Finlanda me seli ne Finlande.

b). Statuti

OJQ "YMCA MOVEMENT-YMCA LEVIZJE IN KOSOVO" veprimtarinë e vet e ka të rregulluar sipas Statutit të Organizatës të cilin e ka aprovuar me datën 15 Janar 2013, ndërsa është propozuar harmonizimi me Ligjin nr 06/L-043 Për Lirin e Asociimit në Organizata Joqeveritare në Kuvendin e saj të mbajtur me date 23 Shkurt 2020. Ndryshimi i emrit nga George Williams Youth Association in Kosovo (shkurt: GWY) në YMCA MOVEMENT-YMCA LËVIZJE është aprovuar nga Kuvendi i Anëtarëve me datë 18 Qershor 2020.

Disa nga Rregullat e këtij statuti përshkruajnë se:

- Organizata është themeluar me qëllim të:
Të promovoja vlera dhe barazi për të gjithë pa asnjë dallim dhe të ofroj zhvillim të rinisë dhe komunitetit në Kosovë dhe jashtë saj (neni 3.1);
- Sipas nenit 3.2 të Statutit, Fushëveprimtaria e organizatës është:
 - Promovimin dhe fuqizim e rolit të rinisë në shoqëri;
 - Shërbime përgaditje të të rinjëve për punësimin dhe edukimin e të rinjëve;
 - Programet e shkëmbimit të të rinjëve jashtë shtetit;
 - Programet për zhvillim të fëmijëve;
 - Programet tona bazohen në Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara;
 - Puna jonë bazohet në Paris Basis dhe principet e Aleancës Botërore të YMCA;

Përfaqësuese e autorizuar e organizatës është Drejtoresha Ekzekutive z-nga Dorina Davies.

YMCA MOVEMENT

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në euro)

Me 31 Dhjetor 2020 Organizata kishte 27 punonjës (31 Dhjetor, 2019:23 punonjës).

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RËNDËSISHME KONTABËL

2.1. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat Financiare janë preqatitur në përputhje me kërkesat financiare te DONATORËVE. Mbi këtë bazë, të ardhurat, në rastin e financimit nga donatoret, njihen kur pranohen e jo kur fitohen dhe shpenzimet njihen kur paguhen e jo kur ndodhin. Pagat, qiraja dhe shpenzimet e komisioneve bankare në fund të vitit janë regjistruar në bazë akruale te kontabilitetit.

2.2. Valuta Raportuese

Valuta raportuese për përgaditjet e Pasqyrave Financiare është Euro (EUR), që është monedha ligjore ne territorin e Kosovës qe nga 1 Janari 2002. Transaksionet në valuta tjera përveq në Euro regjistrohen me kursin e këmbimit qe mbizotëron në datën kur fondet pranohen ose paguhen.

2.3 Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshinë paratë në dorë, dhe paratë në bankë në një llogari rrjedhëse.

2.4 Prona dhe paisjet

Zërat e prones dhe paisjeve maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nese ka.

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave (ne fitim ose humbje) në bazë lineare përgjatë jetës së dobishme të çdo pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale. Toka nuk zhvlerësohet.

Normat e amortizimit për vitin aktual dhe krahasuese janë si më poshtë:

	<u>Ne %</u>
• Ndertesa	5
• Paisje zyre	20
• Automjetet	20

Metodat e zhvleresimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne çdo datë raportimi.

YMCA MOVEMENT

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në euro)

2.5 Të hyrat nga donacionet

Donacionet nuk njihen derisa të ketë siguri të arsyeshme se Organizata do të jetë në përputhje me kushtet e bashkangjitur për ta dhe se donacionet do te mirren.

Donacionet njihen në pasqyrën e bilancit dhe përdorimin e tyre ne baza sistematike gjatë periudhave në të cilat Organizata njeh si shpenzime kostot e lidhura, për të cilat donacionet kanë për qëllim për tu kompensuar. Në mënyrë të veçantë, grantet kusht primar i të cilave është se Organizata duhet të blejë, ndertoj ose të siguroj pasuritë afatgjata njihen si të ardhura te shtyra ne pasqyrën e pozicionit finanziar dhe transferohet në fitim ose humbje në baza sistematike dhe racionale gjatë jetës së dobishme te aseteve të lidhura.

Grantet që janë te arkëtueshme si kompensim për shpenzime ose humbje tashmë të ndodhura ose për qëllim per të dhënë mbështetje të menjëherëshme financiare per Organizata pa shpenzime të lidhura në të ardhmen, njihen ne pasqyrën e të ardhurave dhe përdorimin e fondeve për periudhat në të cilën ato bëhen të arkëtueshme.

2.6 Të hyrat nga Dyqani

Organizata krijon të hyra nga hapja e dyqanit për shitje me pakicë të artikujve të tekstilit. Të hyrat nga këto shitje përdoren për të njëjtat qëllime që është krijuar organizata dhe nuk përdoren për qëllime komerciale.

Në fund të muajit Mars 2020, YMCA MOVEMENT ka mbyllur dyqanin në Prishtinë I cili është hapur në muajin Dhjetor 2019.

2.7 Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen ne pasqyrën e fondeve dhe përdorimin e fondeve me pagesën për shfrytëzimin e shërbimit ose blerjen e mallrave. Përveq për shpenzimet e pagave, qirasë dhe komisioneve bankare të cilat regjistrohen ne bazë të parimit akrual te kontabilitetit.

2.8 Përfitimet e punëtorëve

Organizata bën kontribute për përfitimet e punonjësve në Trustin e Kursimeve pensionale të Kosovës (TKPK). Kontributet njihen kur ndodhin.

YMCA MOVEMENT

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në euro)

2.9 Tatimi

Organizata është themeluar si organizatë jo fitimprurese në bazë te Ligjit nr.05/L-029 "Mbi tatimin në te ardhurat e korporatave", Organizatat te cilat i perdonin fondet per statusin e tyre publik janë te liruara nga tatimi.

3.PARAJA NË ARKË DHE BANKË

	Me 31 dhjetor 2020	Me 31 dhjetor 2019
	€	€
Mjetet e gatshme ne arkë	392	1,028
Mjetet e gatshme ne bankë	<u>114,693</u>	<u>34,840</u>
	<u>115,085</u>	<u>35,868</u>

Teprica përfaqson parat e gatshme dhe ekzistencen e parave te gatshme dhe vleren e tyre në fund të periudhës .

Organizata transakcionet e veta financiare i realizon edhe me banka. Transakcionet kryhen ne: ProCredit Bank-Dega në Gjakovë.

Paraja e gatshme tek bankat realizon fitim nga kamata në shkallët fikse dhe e cila kamatë përcaktohet nga secila bankë në mënyrë individuale si dhe mund të ndryshohet me vendimin e tyre.

4.Stoqet

	Me 31 dhjetor 2020	Me 31 dhjetor 2019
	€	€
Stoqet	<u>2,568</u>	<u>6,267</u>
	<u>2,568</u>	<u>6,267</u>

Stoqet janë paraqitur me çmimin më të ulët ose në vlerën e realizueshme neto. Shpenzimet e shkaktuara gjatë vendosjes së secilit zë të stoqeve në vendin e tyre të tanishëm dhe konditat janë llogaritur për lëndë të parë dhe për të mira konsumuese si çmim i blerjes sipas metodës së vlerës mesatare.

Stoqet ju përkasin mallërave të dhuruara nga donatorët me qëllim të zhvillimit të aktiviteve të bamirësisë së OJQ-së.

YMCA MOVEMENT

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në euro)

5.AKTIVET MATERIALE

	Me 31 dhjetor 2020	Me 31 dhjetor 2020
	€	€
Toka	40,820	40,820
Objekti	33,414	34,293
Automjetet	19,479	16,883
Inventari dhe paisjet	17,241	15,258
Investimet ne vijim-CAMPI	<u>89,333</u>	<u>89,333</u>
	<u>200,287</u>	<u>196,587</u>

Toka, inventari dhe paisjet janë zërat kryesor të pasurisë së Organizatës.

Toka është siguruar bazuar në Marrëveshtjen e Bashkpunitit në mes të : Y's MEN International Region Danmark(YMI-RD) dhe George Williams Youth Association in Kosovo(GWY) të datës 15 Janar 2016 për **Ndërtimin e hapësirës së sigurt për fëmijë dhe të rinj nga familjet e luftës në Kosovë**.Mjetet për pagesën e tokës janë siguruar nga këta donatorë:

- Donatori Y's MEN në vlerë 30,820.00 euro;
- Donatori Y USA World Service në vlerë 10,000.00 euro;

Toka e blerë gjindet në fshatin Pjetershani,Komuna Gjakovë,Republika e Kosovës me një sipërfaqe prej 10205m² në vlerë 40,820.00 euro.Për këtë tokë gjatë vitit 2017 është kryer pagesa në vlerë prej 40,820.00 euro me datë 29 Nëntor 2017 përmes llogarisë bankare nr XK051117007312000188 të GWY pranë PCB Bankë-dega në Gjakovë,Republika e Kosovës.

Toka është Noterizuar me kontratën LRP 5631/17 dhe Numër të Refrencëc 742/2017 të dates 29 Nëntor 2017 te notere Flutura Zajmi nga K.Gjakovë dhe është kaluar si pasuri e GWY pranë Kadastrës së Komunës së Gjakovës me datë 11.01.2018 sipas Çertifikatës me numër te lëndës 6136-17.

Gjatë vitit 2019 janë kryer punime ndertimore në kamp dhe janë financuar nga këta donator:

- Donatori Y USA në vlerë 2,361.81 euro;
- IPKO Foundation në vlerë 9,051.58 euro;



YMCA MOVEMENT

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në euro)

Duhet potencuar se me datën 22.05.2018 është nënshkruar **Memorandumi i Bashkëpunimit** në mes të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe OJQ-së “George Williams Youth Association in Kosovo”. Qëllimi i Memorandumit është financimi në projektin”Qendra e edukimit jo-formal për rini” me lokacion në fshatin Pjetershën në K.Gjakovës.

Sipas pikës 2.1.1 të Memorandumit, Ministria merrë përsipër të investon mjete financiare në vlerë 150,000.00 euro gjatë vitit 2018.

Ndërsa ne bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit për bashkëfinancimin e projektit “Qendra e edukimit jo-formal për rini” me datën 23.04.2019 është nënshkruar marrëveshja në mes Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe Komuna e Gjakovës për realizim te projektit.

Automjetet, inventari dhe paisjet janë pasuri të dhuruara nga donatorët dhe një pjesë e blerë nga YMCA MOVEMNT për zhvillimin e aktivitetave të YMCA MOVEMNT.

Po ashtu vlenë të theksohet se në muajin Prill 2019 është blerë Objekti-Dyqani me sipërfaqe prej 40m² në Qytetin e Gjakovës, objekt i cili gjindet në ZK Gjakove-J-Qytet me nr te njësisë kadastrale P-70705028-04501-12 sipas Çertifikates me nr te lëndës 942/19 te dates 01.04.2019.

- Donator për blerjen e objektit ka qenë REGION DENMARK në vlerë 33,000.00 euro.
- Donator për blerjen e objektit ka qenë REGION DENMARK në vlerë 2,000.00 euro

Automjetet, invenatri dhe paisjet janë zhvlerësuar me normën 20% sipas politikave të OJQ-së mbi zhvlerësimin. Përmes tabelës më poshtë prezantojmë rrjedhën konsistente të kësaj pasurie:

	Toka	Objekti-Dyqani	Investimet ne vijim	Automjetet	Inventari dhe paisjet	Total
Kosto bleresc/vleresimi						
Me 01 Janar 2019	40,820	0	77920	21,258	4,513	144,511
Shtesat	0	35,173	11,413	5,160	8,114	59,860
Zvoglimet						
Me 31 Dhjetor 2019	40,820	35,173	89,333	26,418	12,627	204,371
Shtesat	0	0	0	10,800	15,600	26,400
Zvoglimet	-		-	-1139		-1139
Gjendja me 31 Dhjetor 2020	40,820	35,173	89,333	36,079	28,227	229,632
Zhvlerësimi akumuluar						
Me 01 Janar 2019	0	0	0	(4,252)	-903	(5,155)
Zhvlerësimi për vitin	-		0	-5,284	-2,525	-7,809
Më 31 Dhjetor 2019	0	0	0	-9,536	(3,428)	-12,964
Zhvlerësimi për vitin		(1,759)	0	-7,064	-7559	-16,382
Më 31 Dhjetor 2020	0	(1,759)	0	-16,600	(10,987)	-29,346
Shuma e mbetur						
Me 31 Dhjetor 2020	<u>40,820</u>	<u>33,414</u>	<u>89,333</u>	<u>19,479</u>	<u>17,240</u>	<u>200,286</u>

YMCA MOVEMENT

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në euro)

6.DETYRIMET AFATSHKURTËRA

	Me 31 dhjetor 2020	Me 31 dhjetor 2019
	€	€
Llogaritë e pagueshme	-	3,454
Kontributet pensionale	711	672
Tatimi ne paga	379	306
Tatimi në qira	69	112
	1,159	4,544

Obligimet afatshkurtëra ju përkasin: obligimeve ndaj institucioneve shtetnore të cilat duhet të paguhen ma së largu deri më daten 15 të muajin vijues.

7.TË HYRAT E SHTYERA

	Me 31 dhjetor 2020	Me 31 dhjetor 2019
	€	€
Rezervat (te hyrat e shtyera)	97,383	46,493
	97,383	46,493

Jane determinuar sipas kriterit të efektit të kompentencës së përkohëshme të vitit. Për një periudhë kohore janë verifikuar kushtet që çuan në regjistrimin e tyre origjinal, miratimit, nëse është e nevojshme, të variacioneve (ndryshimeve) te duhura.

Për vitin 2020, të hyrat e shtyera janë zëri kryesor i obligimeve në Pasqyrën e pozicionit finanziar. Këto të hyra ju përkasin obligimeve që ka shoqata për periudhat vijuese për ushtrimin e aktiviteteve të sajë normale. Njihen në Pasqyrën e të ardhurave në baza sistematike në të njëjtat periudha në të cilat njihen shpenzimet.

YMCA MOVEMENT

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në euro)

8.FONDI

	Me 31 dhjetor 2020	Me 31 dhjetor 2019
	€	€
Fondi	219,399	187,685
	219,399	187,685

Fondi i përketë të pasurive të përfituar nga donacionet dhe dhuratdhënësit e YMCA MOVEMENT.

9.TË HYRAT

	2020	2019
	€	€
Të hyrat nga donatorët e jashtëm	151,027	44,492
Te hyrat nga donarët në vend	6,836	44,675
Te hyrat nga dyqani	16,060	11,653
Te hyrat per zhvlersim te pasurive nga donacionet	15,313	10,217
	189,236	111,037

Për vitin 2020 ka pranuar mjete në vlerë 167,673 ndërsa ka krijuar të ardhura për shpenzime programore nga hyrjet nga donacionet në vlerë 157,863.00 euro dhe të hyrat nga dyqani i YMCA MOVEMENT në vlerë prej 16,060.00 euro. Në vijim paraqiten mjetet nga donacionet-grantet e pranuara nga donatorët jasht Kosovës:

	2020	2019
	€	€
EU	77,954	-
Y's Menette Denmark	12,320	-
Y USA 2019	7,313	19,487
Y's Men International- Time of Fast	6,121.00	6,017
Swiss Embassy	3,000	7,000
Y's Men International	0.00	49,893
UNICEF	59,048	16,338
Care International	24,656	9,493
YMCA Germany	13,976	17,289

USA Embassy	9,447	9,094
Y's Men Gjakova	6000	-
UNDP	5,000	-
Y's Men Denmark	1,000	-
YMCA England and Wales- YMCA Movement Trust Fund	0.00	8,720
Donacion Y's Men Individe	0	2,049
	135,560	145,379

Në tabelën në vijim paraqiten mjetet nga donacionet-grantet e pranuara nga donatorët në vend(Kosovë):

Donatori	Me 31 dhjetor 2020		Me 31 dhjetor 2019	
	€		€	
Te hyra nga Antarësia	1,187		2,167	
IPKO Foundation	10,000		10,000	
MKRS	-		4,000	
YMCA 175 Festival	-		2,585	
Te hyra nga KFOS	-		9,530	
Te hyra nga DRKS-Gjakovë	-		2,500	
Te hyra nga donacion GWY	4,378		4,309	
My Community	488		9,584	
	16,053		44,675	

Organizata krijon të hyra nga hapja e dyqanit në Gjakovë për shitje me pakicë të artikujve të tekstilit. Të hyrat nga këto shitje përdoren për të njëjtat qëllime që është krijuar organizata dhe nuk përdoren për qëllime komerciale. Për vitin 2020 të hyrat nga shitja e mallrave në dyqane kan qenë në vlerë 16,060.00 euro.

10. Shpenzimet e projekteve

	2020	2019
	€	€
Shpenzimet e projekteve	80,924	22,456
	80,924	22,456

Shpenzimet projekteve - ju përkasin shpenzimeve të cilat kanë ndodhë për Grantet e pranuara nga donatorët të cilat ma detalisht janë elaboruar në shënimin 9 të këtyre shpalosjeve.

YMCA MOVEMENT

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në euro)

11. SHPENZIMET OPERATIVE

Shpenzimet e personelit

	2020	2019
	€	€
Pagat bruto	61,758	49,080
Kontributet për sigurim pensional	2,973	2,432
	64,731	51,512

Shpenzimet për personel-Artikulli i mbulon koston e plotë të punonjësve duke përfshirë përmirësimet e meritave, lëvizjes në mes kategorive, shpenzimet e paparashikuara, kostojë e pushimeve te pa shfrytezuara dhe dispozitat e ligjit. Numri i të punësuarve më 31 dhjetor të vitit 2020 ka qenë: 27 të punësuar ndërsa për vitin paraprak 23 të punësuar.

Amortizimi dhe zhvlerësimi

	2020	2019
	€	€
Zhvlerësimi	15,313	10,217
	15,313	10,217

Sa i përketë amortizimit dhe zhvlerësimit specifikohet që të njëjta janë kalkuluar në bazë të jetës së dobishme te aktiveve dhe shfrytëzimit të tyre në gjatësin e përdorimit. Sipas llojeve të pasurisë zhvlerësimi ju përket:

- Zhvlerësimi i objektit-dyqanit në vlerë 1,759.00 euro;
- Zhvlerësimi I automjeteve në vlerë 5,995.00 euro;
- Zhvlerësimi I paisjeve dhe inventarit në vlerë 7,559.00 euro

Shpenzimet operative (vazhdim)

Shpenzimet operative kanë ndodhë nga zhvillimi i aktiviteteve operuese të OJQ-së. Pranohet në relacion me destinimin funksional të shpenzimeve te natyrës te mbetur(tepricave) dhe detalisht janë prezentuar në Pasqyrën e të ardhurave e cila është pjesë e këtij Raporti, sipas llojit këto shpenzime ju përkasin:

YMCA MOVEMENT

Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në euro)

	2020	2019
	€	€
Qiraja	9,109	7,365
Rryma,interneti,materialet,tel	8,696	1,798
Anëtarsia	665	665
Shpenzime te udhimit brenda dhe jasht vendit	3,210	4,541
Ushqim dhe pijë	901	373
Mirembajtje dhe riparim	448	2,057
Shpenzimit e auditimit	1,000	1,000
Sherbime te kontabilitetit	1,500	-
Provizioni bankar	889	548
Renovimi I shtepis se pleqve ne Gjakove	-	3,010
Shpenzimet e renovimit te Objektit-dyqanit	-	3,001
Shpenzime tjera	1,851	2,494
	28,268	26,852

12.ANGAZHIMET DHE KONTIGJENCAT

Sipas pohimeve të drejtimit, Organizata nuk ka pasë angazhime dhe kontigjenca në fund të vitit 2020 dhe as nuk pret të ketë në një periudhë të afërt.

13.NGJARJET PASUESE

Pas datës 31 dhjetor 2020, datës se raportimit, deri në miratimin e këtyre raporteve financiare, nuk ka pasur ndonjë korigjim në pasqyrat financiare.

Megjithate në mesin e muajit Mars 2020 ka ndodhë arritja e pandemise COVID-19 në Republiken e Kosoves.Si rezultat i përhapjes së koronavirusit COVID19, janë krijuar paqartësi ekonomike që ka të ngjarë mund të ndikojnë negativisht apo te shkaktojë ngecje në aktivitetës e OJQ-së . Efekte te tjera financiare mund të ndodhin megjithëse ndikimi i tillë i mundshëm nga to është i panjohur në këtë kohë

14.PARIMI I VLJIMËSISË

Mundësia e vazhdimit të aktivitetit të OJQ-së edhe për 12 (dymbëdhjet) muajit e ardhshëm, në bazë të mjeteve të disponueshme, projekteve aktive dhe planeve të drejtimit nuk vihet në dyshim.

15.APROVIMI I PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyra financiare janë aprovuar nga menaxhmenti dhe janë autorizuar për publikim më 29.03.2021.